



# RAPORTI I PERFORMANCËS

Bashkia Vlorë

2025



BASHKIA VLORE

**Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**



Sweden  
Sverige



**HELVETAS**



BASHKIA VLORË

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë .....	4
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë .....	6
<b>Kategoria: Shërbimet.....</b>	<b>7</b>
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor .....	8
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit .....	6
Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	11
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile .....	15
Menaxhimi i mbetjeve .....	19
Përkujdesi Social.....	23
Strehimi social .....	25
Planifikimi Urban Vendor.....	28
Policia bashkiake .....	32
Transporti publik.....	36
Mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe turizmi .....	39
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore .....	42
<b>Kategoria: Mirëqeverisja .....</b>	<b>47</b>
Burimet Njerëzore.....	48
<b>Kategoria: Menaxhimi Financiar.....</b>	<b>50</b>
Të Ardhurat.....	51
Shpenzime.....	55



## Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim.

Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”, i cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky proces reformash, i shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji “Për financat vendore” (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale.

Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:


1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi i performancës në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura përmes një procesi konsultues me ekspertë tematikë.



BASHKIA VLORË

## Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Bashkia Vlorë është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë dhe shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosa deri në Llogara, vija bregdetare e këtij qyteti është më shumë se 100 km. Rrallë qytete në botë mund të kenë një pozicion kaq të volitshëm gjeostrategjik si e ka qyteti i Vlorës, i cili lidhet me daljen e menjëhershme në det në perëndim dhe mbështetjen e vargmaleve në lindje.

Natyra ndoshta si askund tjetër, ka krijuar një ekuilibër midis malit, detit dhe gjelbërimit. Vlora, qyteti i dy deteve, bregdeti i saj karakterizohet nga një larmi habitatesh, me Adriatikun ranor, me kepe, laguna interesante dhe Jonin shkëmbor, me ujin e kristaltë, me shpella, guva e gjire misterioze.

Bashkia e Vlorës përfshin gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit, i vetmi Park Kombëtar Detar në Shqipëri, një mrekulli e gjallë e natyrës shqiptare. Në këtë territor gjenden tre qendra të rëndësishme të turizmit detar, Vlorë, Radhimë dhe Orikum.

Gjiri i Vlorës është i njohur për burimet e tij natyrore, biodiversitetin e pasur dhe korridoret ekologjike. Është ndër zonat me mundësinë më të lartë të zhvillimit të turizmit në vend, kjo lidhet me daljen direkte në det, klimën, ujin, me pasuritë e shumta arkeologjike, historike, kulturore, njerëzore dhe asetet ekonomike.



## BASHKIA VLORË

Bashkia Vlorë ka në qendër të vizionit të saj një qëllim të qartë, të krijojë një rritje të qëndrueshme që përfshin çdo pjesëtar të komunitetit. Zhvillimi nuk matet vetëm me ndërtesa të reja apo rrugë të asfaltuara, por edhe me cilësinë e jetës së njerëzve që jetojnë aty.

Strategjia e zhvillimit të Bashkisë Vlorë synon përmirësimin e infrastrukturës turistike, rrugore dhe shërbimeve publike, nxitjen e investimeve vendore dhe të huaja, si dhe mbështetjen e prodhuesve dhe sipërmarrësve lokalë.

Bashkia Vlorë ka zgjedhur turizmin si një sektor kryesor dhe si një katalizator të rritjes ekonomike për shkak të kontributit të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe rritjen e njohurive dhe vetëdijes kulturore midis vendeve. Shfrytëzimi i potencialit natyror dhe kulturor të zonës, bëhet duke mbrojtur mjedisin dhe trashëgiminë historike.

Strategjia gjithashtu përfshin masa për rritjen e punësimit, forcimin e ekonomisë lokale dhe përmirësimin e mirëqenies së banorëve, duke krijuar një ekonomi konkurruese dhe të qëndrueshme në nivel rajonal.

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Vlorë mbështetet kryesisht në sektorët e turizmit, tregtisë, shërbimeve dhe aktiviteteve bregdetare, si peshkimi dhe transporti detar. Bashkia ka gjithashtu potencial për zhvillim industrial dhe energjetik, duke kontribuar në diversifikimin e ekonomisë lokale. Strategjitë e zhvillimit ekonomik synojnë përmirësimin e infrastrukturës, nxitjen e investimeve vendore dhe të huaja, mbështetjen e sipërmarrësve dhe prodhuesve lokalë, si dhe rritjen e mundësive të punësimit. Qëllimi kryesor është krijimi i një ekonomie të qëndrueshme, konkurruese dhe të orientuar drejt rritjes së mirëqenies së komunitetit.



BASHKIA VLORË

## Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

Bashkia Vlorë është një nga njësitë më të rëndësishme administrative dhe ekonomike të Shqipërisë, e vendosur në jugperëndim të vendit, në qendër të bregdetit shqiptar. Me një territor prej rreth 616 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej afro 125,000 banorësh, Vlora përfaqëson një ndër bashkitë me potencialet më të mëdha zhvillimore në nivel kombëtar dhe rajonal. Qendra administrative e bashkisë është qyteti i Vlorës, i cili shërben si nyje strategjike për turizmin, transportin detar, arsimin dhe aktivitetet ekonomike të Jugut të Shqipërisë.

Vlora ka një rol të veçantë në historinë dhe identitetin kombëtar shqiptar si qyteti i Pavarësisë. Simbolika e saj historike, bashkuar me potencialet natyrore dhe njerëzore, e vendos Bashkinë Vlorë në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe kombëtar.

Vlora është një qendër e rëndësishme arsimore në Jug të Shqipërisë, me Universitetin “Ismail Qemali” si institucion të lartë arsimor që kontribuon në zhvillimin akademik dhe profesional të të rinjve.

Në qytet funksionojnë institucione të shumta kulturore, muzeale dhe artistike, ndërsa aktivitetet shoqërore dhe kulturore e bëjnë jetën urbane dinamike dhe gjithëpërfshirëse.

Popullsia e Bashkisë Vlorë është e përqendruar kryesisht në qytetin qëndror dhe disa zona rurale përreth. Banorët karakterizohen nga një strukturë demografike e përzier dhe lidhje e fortë me traditat, kulturën dhe mënyrën e jetesës lokale. Shumica e popullsisë angazhohet në aktivitete ekonomike si turizmi, tregtia, shërbimet dhe peshkimi, ndërsa disa komunitete merren edhe me bujqësi dhe blegtori. Migrimet drejt qyteteve të mëdha dhe jashtë vendit kanë ndikuar në shpërndarjen e popullsisë, por komuniteti vazhdon të ruajë identitetin kulturor, historik dhe lidhjen me mjedisin natyror të zonës.



BASHKIA VLORE

## Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.

Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.



BASHKIA VLORË

## ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR

*Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015, i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik, kopshtet. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financiar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit. Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe raporti fëmijë-mësues.*



## Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

## Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	2404	2126	2091	1944
Klasa në sistemin parashkollor	166	135	129	121
Numri i mësueseve mbështetëse	32	30	41	40
Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar	37	35	43	41
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor	180	180	221	146
Numri total i godinave të kopshteve	45	42	42	42
Edukatorë të kualifikuar/trajnuar	180	180	170	146
Numri i kopshteve ku është ngritur bordi i kopshtit	45	42	42	42
Numri i kopshteve ku është ngritur këshilli i prindërve	45	42	42	42
Aktivitete sensibilizuese për rëndësinë e shkollës dhe arsimit parashkollor	3	3	4	5




BASHKIA VLORË

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor*

Të dhënat për numrin e fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor në bashkinë Vlorë tregojnë disa tendenca interesante për periudhën 2021-2024. Në vitin 2021, numri i fëmijëve të regjistruar ishte 2404, që përfaqëson një bazë fillestare për krahasim. Në 2022, ky numër u ul në 2126, duke treguar një rënie të lehtë në regjistrimet parashkollore. Reduktimi i mëtejshëm u vu re edhe gjatë viteve 2023, 2024 ku numri ra përkatësisht në vlerat 2091 dhe 1944. Nga të dhënat e mbledhura për periudhën 2021–2024, vërehet një tendencë në ulje të numrit të regjistrimeve në kopshte. Kjo prirje lidhet kryesisht me rënien e lindshmërisë në nivel kombëtar, emigrimin e familjeve, si dhe faktin që ndjekja e kopshtit nuk është e detyrueshme. Megjithatë, pjesëmarrja më e lartë vërehet në grupet e treta, ku përfshirja është më e qëndrueshme falë përgatitjes për arsimin fillor. Ky fenomen tregon rëndësinë e nxitjes së frekuentimit në moshat më të hershme për zhvillim më të mirë social e konjitiv.






BASHKIA VLORË

- *Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor*

Të dhënat për numrin e mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor në bashkinë Vlorë tregojnë ndryshime të ndjeshme nga viti në vit. Numri i mësuesve u raportua të ishte 180 në 2021 dhe mbeti i pandryshuar në 2022. Një rritje e dukshme ndodhi në 2023, ku numri i mësuesve arriti në 221. Kjo shënon një rritje prej 41 mësuesve krahasuar me vitin paraardhës. Megjithatë, në 2024, numri i mësuesve ra ndjeshëm në 146, që është një reduktim prej 75 mësuesve nga viti 2023. Këto ndryshime mund të reflektojnë mbi politikat arsimore, nevojat demografike apo faktorë të tjerë social-ekonomikë. Reduktimi në 2024 mund të jetë një objekt shqetësimi nëse vazhdon të ndodhë në vitet që pasojnë. Studimi i këtyre prirjeve është i rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e arsimit parashkollor në Vlorë.






BASHKIA VLORË

- *Numri i mësueseve mbështetëse*


Bashkia Vlorë ka treguar një kujdes të vazhdueshëm për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet parashkollore. Bashkia Vlorë është e vetmja bashki në rang kombëtar që ka raportin gati 1:1, një fëmijë për një mësues ndihmës. Numri i mësueseve ndihmëse në kopshtet publike të Bashkisë Vlorë është rritur në mënyrë të njëtrajtshme me numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Aftësia e kufizuar dhe integrimi i fëmijëve në institucionet arsimore po merr prioritet në Shqipëri. Ndihma e herët për fëmijët me aftësi të kufizuar është një faktor kyç në zhvillimin sa më të mirë të fëmijës dhe përmirësimin e aftësive intelektuale, aspektin social dhe emocional, pavarësinë praktike dhe fushën e njohjes. Gjithnjë e më shumë prindërit po ndërgjegjësohen dhe fëmijët po marrin diagnozën dhe shërbimin e duhur. Fushatat sensibilizuese në nivel lokal e kombëtar dhe emancipimi i vazhdueshëm i shoqërisë shqiptare, po e bën gjithnjë e më të lehtë pranimin e realitetit dhe njohjen e aftësisë së kufizuar si pjesë e shoqërisë. Kujdesi i treguar nga Bashkia Vlorë përbën një hap pozitiv drejt integritit, por vërehet gjithashtu edhe domosdoshmëria për përmirësimin e infrastrukturës për aksesueshmëri fizike dhe pajisje ndihmëse. Kopshtet që janë të pajisur me rampa për fëmijët me aftësi të kufizuar janë vetëm 3, ndërsa kopshtet e pajisur me tualete për fëmijë me aftësi të kufizuar 1. Grafikët e mëposhtëm paraqesin grafikisht shpërndarjen e mësueseve mbështetëse dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar gjatë viteve 2020-2024.





BASHKIA VLORË

- *Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar*





BASHKIA VLORË

## MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

*Shërbimi i ujitje-kullimit përfshin mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore u transferua bashkive në vitin 2016. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.*





BASHKIA VLORË

## Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024
Përmirësimi i rrjetit ujitës	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	30.15	25.68	20.52	
Kultivimi i tokës bujqësore	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të kultivuar ndaj sipërfaqes totale bujqësore	73.41	73.41	73.41	73.41




BASHKIA VLORË

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- *Përmirësimi i rrjetit ujitës*

Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)

Të dhënat për bashkinë Vlorë tregojnë përqindjen e kanaleve vaditëse të pastruara kundrejt rrjetit total të tyre gjatë viteve 2021-2024. Në vitin **2021**, **30.15%** e kanaleve janë pastruar, duke shënuar një përpjekje domethënëse për mirëmbajtjen e rrjetit vaditës. Në vitin **2022**, vihet re një ulje të përqindjes në **25.68%**, e cila pasohet me ulje të lehtë në **20.52%** në vitin **2023**, që tregon ndoshta sfida ose prioritete të ndryshueshme në menaxhim. Të dhënat theksojnë rëndësinë e vlerësimit të strategjive aktuale dhe përmirësimit të procesit të mirëmbajtjes. Për të shmangur ndikimet negative afatgjata, bashkia duhet të rishikojë situatën dhe të përshtatë qasjet menaxheriale në kanalizimin e resurseve.





BASHKIA VLORË

## Të dhënat e shërbimit


Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	15520	11500	11500	11500
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	441	441	371.5	371.5
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	230	230	230	230
Numri i stafit i angazhuar për shërbimin	17	17	19	19
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	750	750		
Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	69.35	59.07	47.2	
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	10850	10850		
Kanale ujitëse dhe kullues të pastruar/mirëmbajtur (në km)	69.35	59.07	58.44	

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km*

Të dhënat e bashkisë Vlorë tregojnë ndryshime në gjatësinë e rrjetit ujitës të mirëmbajtur dhe pastruar gjatë viteve të fundit. Viti **2021** shënon një mirëmbajtje dhe pastrim të rrjetit ujitës me një gjatësi prej **69.35 km**, që përfaqëson kulmin në këtë periudhë katër vjeçare. Në vitin **2022**, ka një rënie në **59.07 km**, që tregon një reduktim në aktivitetet e mirëmbajtjes krahasuar me vitin paraardhës. Në **2023**, rrjeti i mirëmbajtur u reduktua më tej, duke arritur në **47.2 km**. Këto shifra sinjalizojnë një trend në rënie të mirëmbajtjes së përvitshme nga **2021** deri në **2023**. Rënia e vazhdueshme mund të pasqyrojë sfida operationale, financiare, ose prioritete të ndryshuara të bashkisë. Kjo ulje në mirëmbajtje mund të ndikojë në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit ujitës të rajonit. Analiza e mëtejshme është e nevojshme për të kuptuar faktorët që kontribuan në këto ndryshime. Mirëmbajtja e rregullt dhe e qëndrueshme e rrjetit ujitës është kritike për zhvillimin rural dhe bujqësor të zonës.





BASHKIA VLORË

## ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

*Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe afrim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimit të shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mbikqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e licencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrole të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.*





BASHKIA VLORË

## Treguesit e shërbimit


Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024
Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullor	Numri i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota	0.62	0.7	0.98	1.2
Përmirësimi i kapaciteve të punonjësve për administrimin e pyjeve dhe kullotave	Raporti i punonjësve të trajnuar kundrejt numrit total të punonjësve të programit (në %)	14.29	0	9.09	15.38

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Të dhënat për numrin e punonjësve për **1000 ha** pyje dhe kullota në Bashkinë Vlorë tregojnë një variacion të konsiderueshëm ndër vite. Në vitin **2021**, numri i punonjësve për **1000 ha** ishte **0.62**. Një rritje e vogël u vu re në vitin **2022**, kur ky numër arriti në **0.71**, duke treguar përmirësime të mëtejshme. Kjo tendencë pozitive vazhdoi edhe në vitin **2023** me **0.98** dhe në **2024** arriti vlerën **1.2** punonjës për **1000 ha**, kjo rritje flet për qëndrueshmërinë e përpjekjeve në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave. Të dhënat mbeten domethënëse për planifikimin e ardhshëm dhe ndërhyrjet për përmirësim të vazhdueshëm.





BASHKIA VLORË

## Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024
Plan menaxhimi	1	1	1	1
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	7149	7149	7149	7149
Numri i punonjësve për menaxhimin pyjeve dhe kullotave	7	8	11	13
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	4052	4052	4052	3847
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	11201	11201	11201	10777.65
Numri i punonjësve të administrimit të pyjeve të trajnuar	1	1	1	2
Aktivitete sensibilizuese për mbrojtjen dhe rëndësinë e pyjeve	5	5	6	7



BASHKIA VLORE

## MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE

*Funksioni i menaxhimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi iu transferua Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 2016. Në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, deri në fund të vitit 2018 u ngritën stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, secili me një strukturë minimale prej 14 punonjësish. Analiza e këtij shërbimi mbështetet kryesisht në dy tregues kryesorë: numrin e zjarrfikësve për çdo 1.500 banorë dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10.000 banorë. Në nivel kombëtar, raporti aktual është afërsisht një zjarrfikës për 1.500 banorë. Një tendencë e ngjashme vërehet edhe në aspektin e mjeteve zjarrfikëse, ku disponueshmëria e tyre bie në raport me rritjen e madhësisë së bashkive. Bashkia është përgjegjëse për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimin në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.*





BASHKIA VLORË

## Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024
Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës	Zjarrfikës të trajnuar/zjarrfikës total (në %)	0	14.63	7.14	7.32
Numri i banorëve për zjarrfikës	Raporti i numrit të banorëve ndaj numrit të zjarrfikësve (banorë për 1 zjarrfikës)	5816.03	5008.27	3214.5	3292.9



BASHKIA VLORË

## Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	2021	2022	2023	2024
Numri i punonjësve të MZSH Meshkuj	34	40	42	41
Numri i punonjësve të MZSH Femra	1	1	1	1
Numri total i popullsisë	203561	205339	135009	135009
Zjarrëfikës në dispozicion	35	41	42	41
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	35	42	42	41
Numri i stacioneve MSZH	2	2	2	2
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga MZSH	819	833	720	1056
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatarja ditën dhe natën)	50	50	50	50
Familje të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të shpërblyera	9	11	0	352
Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri	9	9	12	13
Zjarrëfikës të trajnuar	0	6	3	3



BASHKIA VLORË

- *Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH*

Të dhënat e menaxhimit të rasteve të zjarreve dhe shpëtimit nga MZSH në bashkinë Vlorë tregojnë variacione të ndjeshme ndërmjet viteve. Në vitin **2021**, numri i rasteve të menaxhuara ishte **819**. Në vitin **2022**, raportohen **833** raste, duke treguar një rritje të lehtë nga viti i kaluar. Megjithatë, viti **2023** shënon një rënie në **720** raste, duke reflektuar përpjekje të mundshme për parandalimin e zjarreve ose përmirësimin e menaxhimit të situatave emergjente. Rritja për vitin **2024** është një rritje e konsiderueshme, me një raportim prej **1056** raste, që sugjeron një sfidë të mundshme në rritje ose shtim të kapaciteteve menaxhuese të MZSH. Këto ndryshime mund të lidhen me faktorë klimatikë, urbanizimin, ose politikat e sigurimit të sigurisë publike. Është e rëndësishme të theksohet se rritjet dhe uljet e numrit të rasteve mund të ndikohen edhe nga ndryshimet në protokollet e raportimit apo ndërhyrjes. Rritja e numrit të rasteve në vitin **2024** kërkon vëmendje të veçantë për të shmangur mbingarkesën e strukturave të emergjencës. Bashkia mund të kërkojë masa shtesë parandalimi dhe edukimi të komunitetit për të reduktuar rreziqet e zjarrit dhe nevojën për shpëtim. Këto të dhëna mund të përdoren për planifikim të mëtejshëm të fondeve dhe burimeve në mënyrë efektive.





BASHKIA VLORË

## MENAXHIMI I MBETJEVE

*Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, bashkitë kanë detyrimin për administrim, mbikqyrjen, inspektimin, organizimin ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; administrimin e granteve, huave ose financimeve për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; pastrimin e rrugëve, parqeveve etj. Ky funksion përfaqëson një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të bashkisë, me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve.*





BASHKIA VLORË

## Treguesit e shërbimit

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Në vijim paraqiten të gjithë treguesit e miratuar, të cilët pasqyrojnë aspektet kryesore të shërbimeve vendore. Për secilin prej tyre janë dhënë vlerat përkatëse ndër vite, si dhe të dhënat shoqëruese që mundësojnë interpretim të saktë dhe ndjekjen e tendencave

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim në zonen rurale	Raporti i popullatës së mbuluar me shërbim në zonën rurale kundrejt totalit të popullatës rurale (në %)	100	100	0	0
Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Raporti në % i popullsisë së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj popullsisë totale të bashkisë	100	100	100	100
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim në zonen urbane	Raporti i popullatës së mbuluar me shërbim në zonën urbane kundrejt totalit të popullatës urbane (në %)	100	100	100	100
Rritja e territorit të mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	100	100	0	0



BASHKIA VLORË

## Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024
Sipërfaqja gjithsej e bashkisë	616.85	616.85	616.85	616.85
Depozitimi i mbetjeve në vende me leje mjedisore (verifiko PO = 1, JO= 0)	1	1	1	1
Numri i gjobave të vendosura për ndërtimet pa leje	128	145	168	199
Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	203561	205339	135009	135009
Sasia totale e mbetjeve urbane	70000	70000	60000	65700
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në qytet	51000	51000	45000	50700
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në NJA	19000	19000	15000	15000
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në km <sup>2</sup>	616.85	616.85	616.85	616.85
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane (ditë në javë)	7	7	7	7
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA herë në javë)	5	5	5	5
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat rurale (ditë në javë)	3	3	3	3




BASHKIA VLORË

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Sasia totale e mbetjeve urbane*

Të dhënat për sasinë totale të Mbetjeve Urbane në bashkinë e Vlorës tregojnë një trend ndryshues gjatë pesë viteve të fundit. Në **2021**, bashkia regjistroi një sasi mbetjesh prej **70,000** tonë, një vlerë e cila është identike me atë të vitit **2022**. Në **2023**, ka pasur një ulje të vëllimit të mbetjeve duke arritur në **60,000** tonë, çka përfaqëson një rënie prej **14.3%** krahasuar me vitet **2021** dhe **2022**. Për vitin **2024**, sasia e mbetjeve u rrit në **65,700** tonë, e cila është **9.5%** më shumë se viti **2023**. Ky trend sugjeron një përpjekje për të kontrolluar dhe menaxhuar mbetjet në mënyrë më efektive. Rritja në **2024** mund të jetë rezultat i një popullsie në rritje ose ndryshimeve në praktikat e menaxhimit të mbetjeve. Në përgjithësi, variacionet në sasi ndoshta pasqyrojnë ndryshime në sjelljen e konsumatorëve, infrastruktura ose politika të reja për menaxhimin e mbetjeve. Këto shifra theksojnë rëndësinë e planifikimit strategjik në menaxhimin e mbetjeve urbane për bashkinë e Vlorës.





BASHKIA VLORE

## PËRKUJDESI SOCIAL

*Shërbimi përfshin dhënien e përfitimeve në para dhe në natyrë për familjet me fëmijë, duke përfshirë pagesa për nëna, grante për lindje, mbështetje për kujdesin e fëmijëve dhe pagesa periodike ose të menjëhershme për të ndihmuar familjet në përbalimin e kostove specifike, si ato të energjisë, ujit dhe shërbimeve sanitare. Përfshihet gjithashtu ndihma për kujdestarët e fëmijëve, strehimi dhe ushqimi për fëmijët dhe familjet (jetimore, familje kujdestare etj.), si dhe dhënia e mallrave dhe shërbimeve për familjet, të rinjtë dhe fëmijët. Shërbimi mbulon gjithashtu përfitimet në para dhe natyrë për personat në rrezik për përjashtim shoqëror, përfshirë personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantët, refugjatët, viktimat e dhunës dhe abuzuesit e substancave, duke përfshirë kompensimin e pagave, strehimin afatshkurtër dhe afatgjatë, vakte ushqimi, këshillim, ndihmë për kryerjen e punëve të përditshme dhe furnizim me ushqim, veshje ose lëndë djegëse. Shërbimi mbështetet nga fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesave për personat me aftësi të kufizuara, dhe përfshin administrimin, organizimin dhe mbështetjen e skemave të mbrojtjes shoqërore."*





BASHKIA VLORE

## Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	2021	2022	2023	2024
Numri i punonjesve të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet në nevojë	8	8	11	11
Edukatore në çerdhe	8	8	9	9
Fëmijë të regjistruar në çerdhe	56	66	82	78
Numri total i godinave të kopshteve	45	42	42	42
Numri total i godinave të çerdheve	3	3	3	3
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	2385	2315	2165	2091
Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale	48	45	45	45
Fëmijë të shërbyer në qendra ditore	16	104	60	50
Numri i punonjësve që kujdesen për personat PAK	14	13	14	14
Numri i shërbimeve të ofruara për pak-të në shtëpi-familje	4	4	4	4
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti Femra	2718	2623	1359	1236
Numri total i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	822	721	558	635
Viktima të dhunës në familje të asistuar	228	150	60	90
Invalidë përfitues nga ndihma sociale	103	76	73	88
